

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Aricoma a.s., me seli në Vinohradska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, përmes përfaqësueses së autorizuar Tatjana Popovski Buloski, avokate nga Shoqëria e Avokatëve Popovski dhe Partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 22.05.2024, solli këtë

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Aricoma a.s., me seli në Vinohradska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, do të fitojë kontroll të plotë mbi KCT Data s.r.o, me seli në Valčikova 1369/17, Liben 182 00 Pragë 8, Republika Çeke, përmes shitblerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë të tij thelbësore, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptimin e nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit është i detyruar të paguajë tarifën administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6.000 denarë dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000 denarë, sipas numrit tarifor nr. 34 të Ligjit për Taksa Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 22.04.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga Aricoma a.s., me seli në Vinohradska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, me të cilin Aricoma a.s. do të fitojë kontroll të plotë mbi KCT Data s.r.o., me seli në Valčikova 1369/17, Libeň 182 00 Pragë 8, Republika Çeke, përmes shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Aricoma a.s. është kompani holding që menaxhon pjesët në kompanitë e saj bijë – veçanërisht Aricoma Sistems a.s. (më parë me emrin Autocont AEC a.s.), Sabris Konsalting s.r.o., dhe Aricoma Enterprajs Sabejskjuriti a.s.

Aricoma Sistems a.s. fokusohet në implementimin e projekteve për ndërmarrje të mëdha dhe klientë të mëdhenj, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve informative të biznesit të Microsoft Dynamics, dhe ofron infrastrukturë IT, aplikacione korporative, mbështetje për proceset e biznesit, kujdes për klientët dhe siguri IT.

Sabris Konsalting s.r.o. fokusohet në ekspertizën SAP, zgjidhjet e biznesit dhe shërbimet e lidhura. Aricoma Enterprajs Sabejsejuriti a.s. ofron teknologji sigurie, vlerësim të sigurisë, shërbime të mbrojtjes kibernetike dhe shërbime konsulence për GDPR/përputhshmëri.

Aricoma a.s. i përket Grupit KKCG. Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjinë, pasuritë e paluajshme dhe teknologjitë informative.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në treg përmes shërbimeve të terminaleve për video-lotari dhe teknologjive informative përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAQEDONIA SHPK Shkup, me veprimtari kryesore – lojërat e fatit dhe bastet;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë – KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari kryesore – lojërat e fatit dhe bastet;
- Kinshift SHPKNJP Shkup, më parë me emrin Seavus SHPKNJP Shkup, me veprimtari kryesore – programim kompjuterik; dhe
- Shoqëria për edukim kompjuterik dhe zhvillim të inovacioneve Kinshift Academy SHPKNJP Shkup, më parë e njohur si qendra arsimore dhe zhvillimore Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet prioritar - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër;
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft SHPKNJP Shkup – me veprimtari kryesore – programim kompjuterik.

KCT Data s.r.o është me një aktivitet prioritar në sektorin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e

konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска